

STATUTI
(*“Statuti”*)

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

‘MODERN ENGINEERING’ Sh.p.k.

(*“Shoqëria”*)

Themeluesi i shoqërisë:

Ergys Bardhi, i biri i Naimit, lindur në datën **01.11.1983**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me numër personal **I31101015L**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

i cili në vijim do të referohet si *“Themeluesi / Ortaku i vetëm”*

Sot më datë 04.02.2025, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar, themelon Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, e cila do të rregullohet nga dispozitat e përcaktuara në këtë Statut dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

KAPITULLI I

EMRI, FORMA LIGJORE, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1. Emri i Shoqërisë

1.1 Emri i Shoqërisë është *“Modern Engineering”*, ndjekur në vijim nga inicialet **“Sh.p.k.”**, që përfaqësojnë formën e saj ligjore, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 Ortakët e Shoqërisë (*“Ortakët”*) kanë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës, përfaqësuar në Kuota, në kapitalin e Shoqërisë.

1.3 Në dokumenta, fatura, njoftime dhe botime të tjera të nxjerra prej Shoqërisë, emri i saj do të shoqërohet nga:

- Fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “Sh.p.k.”,
- nga numri unik i regjistrimit (NIPT),
- selia ligjore, dhe
- shënimi nëse Shoqëria është në procedurë likuidimi, nëse është rasti i tillë.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërisë

2.1 Shoqëria është një person juridik i themeluar dhe rregulluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me formë ligjore të një shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Ligjit Nr.

9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar (“**Ligji i Shoqërive Tregtare**”).

Neni 3. Selia Ligjore

3.1 Selia ligjore e Shoqërisë është: **Rruga ‘Tefta Tashko’, Nd. 20, Ap. 12, Tiranë, Shqipëri**. Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme / Ortakut të Vetëm mund të zhvendosë seline e saj ligjore në një adresë dhe/ose vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme / Ortakut të Vetëm mund të celë degë dhe zyra perfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 4. Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të papërcaktuar.

KAPITULLI II

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 5. Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

Studimi, projektimi, supervizioni dhe kolaudimi i projekteve dhe zbatimi i objekteve ndërtimore, konsulenca inxhinierike në fushën e projektimit dhe ndërtimit, konsulenca në strukturat e inxhinierisë civile, arkitekturës, studimeve urbanistike dhe ambientale, realizimi i projekteve dhe kolaudimeve të efikasitetit të energjisë etj, sipas licencës profesionale të lëshuar nga organi kompetent shtetëror.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu studime e kërkime, konsulencë e projektim në sektoret e sipërpërmendura. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet që rezultojnë të nevojshme apo të dobishme për plotësimin e qëllimit të saj.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha ato veprimtari të çdo lloji natyre të nevojshme për arritjen e objektit themelor dhe që nuk bien në kundërshtim me ligjin, përveç atyre të përmendura më sipër.

Neni 6. Modifikimi

6.1 Shoqëria rezervon të drejtën të ndryshojë ose të shtojë objektin e aktivitetit në çdo moment, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

KAPITULLI III

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 7. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është 1000 Lek (një mijë Lek), i ndare në 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1000 Lek (një mijë Lek), të nënshkruara plotësisht dhe të vlefshme ("Kuotat").

Article 8. Ortakët e Shoqërisë dhe Kotat e mbajtura prej tyre

8.1. Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat e mbajtura prej tyre janë si më poshtë:

- (i) **Z. Ergys Bardhi**, shtetas Shqiptar, lindur në 01.11.1983, në Tiranë, Shqipëri (më poshtë i referuar si "**Ortaku i Vetëm**"), i cili zotëron 1 (një) Kuotë të nënshkruar dhe paguar plotësisht, me vlerë nominale prej 1000 Lek (një mijë Lek), për një vlerë totale prej 1000 Lek (një mijë Lek), duke përfaqësuar 100 % të kapitalit social të Shoqërisë

Neni 9. Ndryshimi i Kapitalit

- 9.1. Kapitali mund të zmadhohet apo zvogëlohet në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme / Ortakut të Vetëm, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti dhe dispozitave mandatore të Ligjit të Shoqërive.
- 9.2. Kapitali do të zmadhohet me kontribute në para (cash) dhe në natyrë, si dhe duke përfshirë rezervat ose fitimin ose konvertimin e huave në kapital.
- 9.3. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet nëpërmjet emetimit të Kuotave të reja ose duke rritur vlerën nominale të Kuotave egzistuese. Kuotat do të nënshkruhen në vlerën e tyre nominale dhe do të paguheshin plotësisht.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit nuk do të ndryshojë raportin e pjesëmarrjes së Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë, përveçse kur Ortakët bien dakord ndryshe me anë të një vendimi të miratuar me unanimitet.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakut

- 10.1. Ortakët janë të vetmit që zotërojnë Kuota në Shoqëri.
- 10.2. Çdo Kuotë jep të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të Ortakëve ("**Asambleja e Përgjithshme**"), të drejtën për të zgjedhur dhe për të zgjedhur në instancat drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, si dhe të drejtat e tjera që u njihen në bazë të neneve të këtij Statuti, çdo marrëveshje e detyrueshme ndërmjet Ortakëve dhe dispozitat mandatore të Ligjit të Shoqërive Tregtare.
- 10.3. Ortakët kanë të drejtë, në bazë të një kërkesë të shkruar, të marrin informacion dhe të dhëna lidhur me aktivitetin e Shoqërisë, në çdo kohë, duke përfshirë dhe të drejtën për të inspektuar dokumentat dhe librat e Shoqërisë.

- 10.4. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga pronësia mbi Kuotat transferohen tek çdo pronar i ri i këtyre Kuotave.
- 10.5. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nëpërmjet kapitalit të saj, dhe Ortaket mund të bëhen përgjegjës brenda limitit të vlerës së Kuotave që ata mbajnë.
- 10.6. Shoqëria nuk mund të jetë përgjegjëse për detyrime të tjera personale të Ortakëve.

Neni 11. Transferimi i Kuotave

11.1. Në rast se Ortaku i Vetëm dëshiron të shesë, transferoje ose disponojë në forma të tjera me Kuotat në pronësi të tij, të gjitha veprimet në lidhje me kalimin e pronësisë së Kuotave do të bëhen në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare, sipas versionit të tij aktual dhe siç mund të jetë ndryshuar më pas, dhe do të regjistrohet në Librin e Ortakeve.

KAPITULLI IV ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 12 Organet e Shoqërisë

Shoqëria do të organizojë procesin e vendimmarrjes dhe administrimit të saj në përputhje me rregullat e caktuara në Pjesën IV, Titulli IV të Ligjit të Shoqërive Tregtare. Organet e Shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm; dhe
- b. Administratori.

Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm

Neni 13. Kompetencat e Ortakut të Vetëm

13.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi kontrollues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin e saj dhe politiken ekonomike e tregtare. Në këtë rast, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.

13.2 Ortaku i Vetëm do të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- (i) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabel të pavaruar, likuidatorëve dhe Administratorëve dhe aprovimin e skemes përkatëse të shpërblimit;
- (ii) monitorimin dhe supervizionin e performancës së Administratorëve;
- (iii) themelimin, blerjen dhe shitjen e shoqërive apo operacioneve;

- (iv) krijimin ose dhenien e sigurimeve, huave dhe kredive;
- (v) përcaktimin e principeve për dhenien punonjesve në poste drejtuese të drejta pjesëmarrje në fitime dhe xhiro si dhe kontribute pensionesh;
- (vi) strukturen e brëndshme dhe organizative të Shoqërisë;
- (vii) përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e performancës;
- (viii) përfaqesimin e Shoqërisë në gjykata dhe proçedime të tjera kunder Administratorëve;
- (ix) blerjen dhe shitjen, ndarjen dhe anulimin e Kuotave;
- (x) shpërndarjen e fitimit;
- (xi) ndërprerjen e aktivitetit të Shoqërisë dhe/ose mbylljen, shpërndarjen ose likuidimin e Shoqërisë;
- (xii) ndryshimet, amendimet dhe zëvendësimet e aktit të themelimit dhe statutit të Shoqërisë;
- (xiii) ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë;
- (xiv) prezantimin e ndonje peticioni për likuidim ose falimentim;
- (xv) shkrirje me çdo shoqëri tjetër, ose ndarje të Shoqërisë;
- (xvi) blerje, shitje dhe barrësim të pronës së paluajtëshme;
- (xvii) rritje dhe/ose zvogelim kapitali të Shoqërisë;
- (xviii) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Neni 14. Thirrja

- 14.1. Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm do të mbledhet te pakten një here në vit;
- 14.2. Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm duhet të mbledhet, në rastin kur në bazë të pasqyrave financiare vjetore ose pjesore rezulton se egziston rreziku që asetet e Shoqërisë nuk mund të mbulojnë detyrimet e saj në 3 muajt e ardhshëm;
- 14.3. Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm do të mbledhet kur ka një propozim për shitje ose disponim tjetër të aseteve që kanë një vlerë më të madhe se vlera e 5% të aseteve totale të Shoqërisë, sipas pasqyrave financiare të fundit të audituara. Ortaku i Vetëm do të vendosë mbi bazën e një raporti të ekspertit kontabël të autorizuar dërguar kësaj asambleje, përveç kur blerja është bërë në bursë ose është pjesë e aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë;
- 14.4. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet kur Shoqëria propozon të blejë asetë që i përkasin një Ortaku dhe kanë një vlerë që kalon vlera e 5% të aseteve totale të Shoqërisë, sipas pasqyrave financiare të fundit të audituara.
- 14.5. Në kushtet e përcaktuara në seksionet 14.3., dhe 14.4., këtu më sipër Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bazën e një raporti të ekspertit kontabël të autorizuar dërguar kësaj asambleje.
- 14.6. Ortakët do të takohen periodikisht me Administratorët për të revizionuar veprimet e tyre ndërmjet takimeve, diskutojnë për çështjet lidhur me administrimin e Shoqërisë dhe të vendosë mbi çështjet që janë objekt i aprovimit të Ortakeve, përfshirë dhe çështjet për të cilat Administratorët nuk bien dakort.

- 14.7. Në rrethanat e përcaktuara në seksionet 14.3., deri 14.6., këtu me lart, Asambleja e Përgjithshme mund të kalojë një vendim këshillues duke aprovuar ose jo performancën e Administratoreve.

Neni 15. Metoda e thirrjes

- 15.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë mbi çështjet e përcaktuara në Seksionet 13 dhe 14, këtu më sipër, nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme apo të jashtëzakonshme.
- 15.2. Ortaku i Vetëm mund të thirret për vendimmarje nga Administratori, ose nga vetë Ortaku i vetëm.
- 15.3. Vendimet e Ortakut të Vetëm marrë në përputhje me Ligjin e Shoqërive dhe këtij Statuti janë të detyrueshme për Shoqërinë. Çdo vendim i tillë mund gjithashtu të merret jashtë Republikës së Shqipërisë dhe evidenca e shkruar e këtij vendimi do ti dergohet Administratorit, i cili do ta regjistrojë ato në Rregjistrin e Vendimeve të Ortakut të Vetëm.
- 15.4. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një Regjistër të Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 15.5. Në rastet e kërkuara nga legjislacioni, vendimi përkatës i Ortakeve do të noterizohet nga një noter i certifikuar në Shqipëri. Në rast kur këto vendime janë marrë jashtë Republikës së Shqipërisë, ato do ti nënshtrohen kërkesave të legjislacionit Shqiptar lidhur me njohjen e dokumentave të huaja nga Republika e Shqipërisë (p.sh. kryerja e procedurave të supër – legalizimit ose apostilimit, në varësi të vëndit të përgatitjes së tyre).
- 15.10. Administratorët do të mbajnë procesverbalin e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

KAPITULLI V

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 16. Administratorët

- 16.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm, sipas të cilit secili Administrator autorizohet të firmosë dhe përfaqësojë Shoqërinë në menyrë individuale.

- 16.2. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/eve do të jete 5 (pesë) – vjet, nga momenti qe emërimi i tyre do të ketë efekt ligjor (p.sh. rregjistrimi me Qendren Kombetare te Rregjistrimit), me mundësi ri-zgjedhjeje.
- 16.3. Administratori i Shoqërisë do të jetë:
Z. Ergys Bardhi, lindur në Tiranë, Shqipëri, me 01.11.1983, shtetas Shqiptar, rezident në Tiranë, Shqipëri, mbajtes i Id me Nr. Personal I31101015L;
- 16.4. Në rast vdekjeje, dorëheqjeje, përjashtimi ose skualifikimi të ndonjë Administratori, zëvendësuesi që do të zërë vendin bosh do të zgjidhet me vendim të Ortakëve menjëherë pas krijimit të vendit bosh.
- 16.5. Në rastet e lejuara nga dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar ose çdo ligj tjetër ku aktet e Administratorit do të ketë efekt, Administratori do të ketë të drejtën të marri vendime brënda objektit të detyrës së tij edhe pa qënë prezent në zyrat e Shoqërisë në Shqipëri. Administratorët kanë të drejtë të leshojne prokura të përkoheshme ose afat gjata brënda kursit normal të biznesit ku të delegojnë pjesë të kompetencave të tyre personave natyrale brenda ose jashtë Shoqërisë.
- 16.6. Shoqëria do të rimbursoje Administratorin për shpenzimet e arsyeshme të udhetimeve lidhur me prezencën fizike të detyrueshme të Administratoreve në një vend që nuk është brënda qytetit të banimit të Administratorit.
- 16.7. Kompetencat e Administratorit do të përfshijne të drejtën për të:
- (i) administruar biznesin e Shoqërisë duke zbatuar politikat dhe planet e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - (ii) përfaqësuar Shoqërinë;
 - (iii) siguruar që librat kontabel dhe dokumentat e kërkuara të Shoqërisë të mbahen në menyre adekuate;
 - (iv) përgatitur dhe firmosur pasqyrat financiare vjetore dhe llogaritë e konsoliduara, raportin e performancës, sëbashku me propozimet për Asamblene e Përgjithshme për shpërndarjen e fitimit;
 - (v) krijuar një sistem paralajmerimi të shpejtë lidhur me zhvillimet që kërcënojnë egzistencën dhe performancën e Shoqërisë;
 - (vi) dërguar të dhënat e Shoqërisë për rregjistrim në Qendren Kombëtare të rregjistrimit, kur është e aplikueshme;
 - (vii) raportuar para Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave të biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçante për performancën e Shoqërisë;
 - (viii) firmose çeqe, urdhëra, kontrata qeraje, nota zyrtare, drafte dhe dokumenta e instrumenta te tjere ne lidhje me aktivitetin e Shoqërisë dhe per te egzekutuar cdo dokument qe kerkon vulen e Shoqërisë, me përjashtim kur ekzekutimi i këtij dokumenti sipas këtij Statuti dhe ligjit kërkohet ose lejohet të ekzekutohet ose firmoset në mënyrë tjetër ose me përjashtim kur nënshkrimi dhe ekzekutimi i këtij dokumenti do të delegohet shprehimisht me vendim të Ortakëve tek një zyrtar tjetër apo agjent i Shoqërisë.

- (ix) kryer çdo lloj detyre tjetër të përcaktura kohë pas kohe nga ligji apo Asambleja e Përgjithshme.
- 16.8. Administratori do të mbikqyrë dhe të sigurojë që zyrtaret, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltaret e Shoqërisë do të veprojnë me kujdesin e duhur dhe për interesin më të favorshëm të Shoqërisë.
- 16.9. Administratori duhet të marrë aprovim paraprak nga Ortaku i Vetëm për çështjet e mëposhtme:
- a) punësimin e të punësuarve me një pagë vjetore (gros) më të lartë se 50,000 Euro (pesëdhjetë mijë Euro);
 - b) procedimin në cilësinë e paditesit në rastet kur shuma objekt i mosmarrëveshjes është më e lartë se 50,000 Euro (pesëdhjetë mijë Euro);
 - c) marrjen përsiper të detyrimeve prej kleringut dhe pranimin e garancive;
 - d) shitje ose krijim i të drejtave reale mbi pronat e Shoqërisë;
 - e) gjithë aktet e tjera ligjore dhe transaksionet e biznesit që dalin jashtë administrimit të përditshëm.
- 16.10. Administratori do veprojë në përputhje me detyrat, detyrimet, përgjegjësitë dhe kompetencat që ju njeh Ligji i Shoqërive. Përveç detyrimeve të përgjithshme dhe të besimit të rregulluara nga Ligji i Shoqërive, Administratori duhet:
- (i) të kryejë detyrat e përcaktuara nga ligji apo Statuti në mirëbesim dhe në interesin më të favorshëm për Shoqërinë në tërësi çfarë përfshin edhe kryerje e aktivitetit në mbrojtje të mjedisit;
 - (ii) të ushtrojnë kompetencat e njohura nga ligji ose ky Statut vetëm për efektet e përcaktuara prej tyre;
 - (iii) të konsiderojë në mënyrë adekuate çështjet për të cilat kërkohet vendim-marrje;
 - (iv) të shmangin konfliktet aktuale apo potenciale ndërmjet interesave të tyre personale dhe atyre të Shoqërisë;
 - (v) të sigurojnë marrjen e aprovimin për çështjet ose marrëveshjet që dalin jashtë kompetencave të dhëna;
 - (vi) të ushtrojnë kujdes dhe aftësi të arsyeshme në kryerjen e funksioneve të tyre.
- 16.11. Në momentin e pranimit të emërimit të tij Administratori njeh dhe pranon, pa pasur nevojë ta formalizojnë këtë në ndonjë dokument të shkruar, që marrëdhënia e tij me Shoqërinë është mbi baza besimi; për këtë arsye vendimi për të hequr Administratorin nga detyra i marre nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, do të konsiderohet si arsye e legjitimuar për shkarkimin, për efekt të legjislacionit të aplikueshëm.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQERISE

Article 17. Eksperti financiar i autorizuar

17.1 Në rastet e kërkuara nga ligji apo sipas diskrecionit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm do të emerojë ekspertët financiar të autorizuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit Shqiptar. Ky ekspert do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- (i) të kontrollojë llogaritë e Shoqërisë dhe të rregjistrojë veprimet dhe transaksionet e saj;
- (ii) të vërtetojë, në përputhje me rregulloret përkatëse, raportin vjetor mbi gjëndjet financiare të Shoqërisë (bilancin, raportet financiare mbi humbjen dhe fitimin dhe raporte të tjera që lidhen me to) dhe të japë mendimin e tij nëse raportet financiare pasqyrojnë me saktësi gjëndjen financiare të Shoqërisë;
- (iii) të informojë Administratorin dhe Ortaket e Shoqërisë për çdo parregullsi apo mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve apo llogarive të Shoqërisë që mund të rezultojnë në humbje materiale për Shoqërinë;
- (iv) të rishikojë përshtatshmërinë e auditimeve të brëndshme dhe të kontrollojë praktikën dhe procedurat e nëse është me vënd, të japë rekomandime për përmirësimin e tyre dhe të kryejë të gjitha detyrat e auditimit të parashikuara nga Ligji Shqiptar.

KAPITULLI VII

AKTIVITETI I SHOQËRISË

Neni 18. Viti Ekonomik Financiar

18.1. Viti ekonomik – financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe përfundon me 31 Dhjetor të këtij viti.

Neni 19. Mbajtja e llogarive dhe librave të Shoqërisë

19.1. Shoqëria do të bëjë mbajtjen e llogarive në Lekë Shqiptare dhe valutë të huaj.

19.2 Shoqëria duhet të mbajë librat, regjistrat dhe dokumentacionin e parashikuar nga legjislacioni shqiptar.

Neni 20. Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

20.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm. Shpërndarjet do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme / Ortaku i Vetëm në përputhje me këtë Statut dhe ligjet në fuqi.

20.2 Në përputhje me Ligjin për Shoqëritë tregtare, Shoqëria mund të bëjë një shpërndarje fitimit tek ortakët vetëm pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 20.3 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë pague, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 20.2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

KAPITULLI VIII

TË NDRYSHME

Neni 21. Regjimi juridik

- 21.1. Shoqëria është themeluar dhe qeveriset në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 22 Të tjera

- 22.1 Të gjitha çështjet e tjera që nuk rregullohen në mënyrë specifike në këtë Statut do të jenë objekt i dispozitave të Ligjit të Shoqërive, tek të cilat duhet referuar edhe për interpretimin dhe plotësimin e dispozitave të këtij Statuti.
- 22.2 Në rast se një nga dispozitat e këtij Statuti bie ndesh me një dispozitë detyruese të Ligjit të Shoqërive Tregtare, apo me dispozita urdhëruese të ligjeve të tjera shqiptare, atëherë çështja e rregulluar nga parashikimi statutor në fjalë do të rregullohet sipas dispozitës detyruese të Ligjit Tregtar apo ligjit tjetër shqiptar. Në një rast të tillë, Asambleja duhet të thirret me urgjencë për të miratuar parashikime të reja statutore, konform Ligjit të Shoqërive Tregtare apo ligjeve të tjera të së drejtës shqiptare.

ORTAKU I VETËM

Z. Ergys BARDHI
